



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 25 prill 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Liburn Aliu, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq.

Munguan: Flora Brovina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 28.03.2012 dhe 03.04.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 28.03.2012 dhe 03.04.2012

Kryesuesi konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të datave 28.03.2012 dhe 03.04.2012, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Fikrim Damka- Tha se e kemi marrë Raportin përfundimtar për Projektligjin për skemën e ndihmës sociale. E kemi një vërejtje nga Komisioni për Legjislacion, lidhur me amendamentin 5 , të cilën duhet ta shqyrtojmë.

Komisioni konstatoj që vërejtjen e adresuar nga Komisioni për Legjislacion për amendamentin 5 të Projektligjit është vetëm një gabim teknik i cili do të përmirësohet në raportin përfundimtar, ndërsa pjesa tjetër duhet të kalojë sepse është harmonizim me nenet tjera të Projektligjit.

Komisioni e miratoi njëzëri Raportin përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka- I njoftoi anëtarët e Komisionit për një ftesë që e ka marrë nga kompania "Ferronikeli" për ta vizituar këtë kompani.

Liburn Aliu- Propozoi që kjo vizitë të kombinohet me vizitën për monitorimin e Ligjit të punës, pra që ato të bëhen së bashku.

Salihe Mustafa- Propozoi që të vizitohet spitali i Gjilanit.

Komisioni vendosi që ta vizitojë kompaninë "Ferronikeli" më 2 maj 2012.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka